



BASHKIA VLORE



# RAPORTI I PERFORMANCËS

Bashkia Vlorë

2025



BASHKIA VLORE

Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Përgatitja teknike e këtij botimi u mbështet nga Smart Processes, në kuadër të asistencës teknike të ofruar për bashkitë nga projekti "Bashki të Forta"



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



Sweden  
Sverige



**HELVETAS**



BASHKIA VLORE

## Tabela e përmbajtjes

<b>Hyrje</b> .....	4
<b>Vështrim i përgjithshëm mbi Bashkinë</b> .....	5
<b>Të dhënat e përgjithshme të Bashkisë</b> .....	7
<b>Sfidat kryesore të Bashkisë Vlorë</b> .....	8
<b>Kategoria: Shërbimet</b> .....	10
ARSIMI BAZË PËRFSHIRË ARSIMIN PARASHKOLLOR .....	11
ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM .....	18
MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT .....	20
ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE .....	23
MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE .....	27
MENAXHIMI I MBETJEVE .....	31
PËRKUJDESI SOCIAL.....	35
STREHIMI SOCIAL .....	38
POLICIA BASHKIAKE.....	42
TRANSPORTI PUBLIK .....	46
MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK.....	50
TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARTISTIKE DHE KULTURORE .....	55
SPORT DHE ARGËTIM.....	59
<b>Kategoria: Mirëqeverisja</b> .....	62
BURIMET NJERËZORE, TRANSPARENCA, BARAZIA GJINORE DHE INTEGRIMI EUROPIAN .....	63
<b>Kategoria: Menaxhimi Financiar</b> .....	71
<b>Të Ardhurat</b> .....	72
Shpenzime.....	74



BASHKIA VLORE

## Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të performancës së bashkisë, duke vlerësuar aspektet kryesore të ofrimit të shërbimeve. Në këtë dokument evidentohen arritjet e deritanishme, si dhe fushat ku nevojitet përmirësim. Qeverisja vendore në Shqipëri ka përjetuar ndryshime të rëndësishme pas miratimit të Ligjit nr.115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale”, i cili konsolidoi 373 bashki dhe komuna në 61 bashki, duke rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike. Ky proces reformash, i shoqëruar nga Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji “Për financat vendore” (2017), ka zgjeruar kompetencat e bashkisë dhe ka forcuar financat vendore, duke mundësuar rritjen e investimeve dhe autonominë fiskale. Miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:


1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse;
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor;
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale;
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Vlerësimi i performancës në këtë raport bazohet kryesisht në të dhënat vetëdeklaruese të bashkisë, të mbledhura përmes një procesi konsultues me ekspertë tematikë.



BASHKIA VLORË

## Vështrim i përgjithshëm mbi Bashkinë



Bashkia e Vlorës është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë dhe përfaqëson një nga territoret me potencialin më të madh zhvillimor, turistik dhe ekonomik në vend. Ajo shtrihet nga gryka e lumit Vjosa deri në Llogara, duke përfshirë mbi 100 kilometra vijë bregdetare, një ndër pasuritë më të rëndësishme natyrore dhe strategjike të Shqipërisë. Pozicioni i favorshëm gjeostrategjik, me dalje të menjëhershme në det në perëndim dhe me mbështetjen e vargmaleve në lindje, i jep Vlorës një identitet unik natyror, ekonomik dhe turistik.

Natyra në këtë territor ka krijuar një ekuilibër të rrallë mes detit, malit dhe gjelbërimit. E njohur si qyteti i dy deteve, Vlora karakterizohet nga një larmi e pasur habitatesh natyrore. Bregdeti i Adriatikut shquhet për plazhet ranore, lagunat dhe kepet natyrore, ndërsa bregdeti i Jonit ofron ujëra të kristalta, gjire, shpella dhe peizazhe shkëmbore me vlera të jashtëzakonshme turistike dhe ekologjike. Në territorin e Bashkisë përfshihen gjithashtu gadishulli i Karaburunit dhe Ishulli i Sazanit, i vetmi park kombëtar detar në Shqipëri dhe një nga asetet më të rëndësishme të biodiversitetit në rajon.

Territori i Bashkisë Vlorë përfshin tre qendra kryesore të turizmit detar: Vlorë, Radhimë dhe Orikum. Gjiri i Vlorës njihet për resurset e tij natyrore, biodiversitetin e pasur dhe rëndësinë ekologjike, duke u konsideruar ndër zonat me potencialin më të lartë për zhvillimin e turizmit në



BASHKIA VLORË

Shqipëri. Ky potencial mbështetet në klimën mesdhetare, pasuritë natyrore, trashëgiminë arkeologjike, historike e kulturore, si dhe në asetet ekonomike dhe njerëzore që ofron territori.

Vlora zë një vend të veçantë në historinë dhe identitetin kombëtar shqiptar, si qyteti ku u shpall Pavarësia e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912. Kjo trashëgimi historike, e kombinuar me potencialet natyrore, kulturore dhe njerëzore, e pozicionon Bashkinë Vlorë si një nga qendrat më të rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm në vend. Vlerat historike dhe simbolike të qytetit ndërthuren me zhvillimin urban, ekonomik dhe turistik, duke e bërë Vlorën një destinacion me rëndësi të veçantë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Bashkia Vlorë ka përcaktuar turizmin si një nga sektorët strategjikë dhe si katalizator të zhvillimit ekonomik lokal, për shkak të ndikimit të tij në rritjen ekonomike, punësimin dhe promovimin kulturor. Zhvillimi i turizmit mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të potencialit natyror dhe kulturor, duke ruajtur njëkohësisht mjedisin dhe trashëgiminë historike. Krahas turizmit, ekonomia lokale mbështetet edhe në tregti, shërbime, aktivitete bregdetare, peshkim dhe transport detar.

Bashkia paraqet potencial të rëndësishëm edhe në sektorët industrialë dhe energjetikë. Në kuadër të vizionit të saj për zhvillim të qëndrueshëm, Bashkia Vlorë synon përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve përmes investimeve në infrastrukturë, modernizimit të shërbimeve publike, mbështetjes së ekonomisë lokale dhe promovimit të turizmit të qëndrueshëm. Strategjitë zhvillimore të bashkisë fokusohen në rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike, nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja, mbrojtjen e mjedisit dhe vlerësimin e pasurive natyrore e kulturore. Qëllimi kryesor mbetet ndërtimi i një qyteti modern, funksional dhe gjithëpërfshirës, që garanton zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale për komunitetin.



BASHKIA VLORË

## Të dhënat e përgjithshme të Bashkisë

Bashkia e Vlorës është një nga njësitë më të rëndësishme administrative, ekonomike dhe turistike të Republikës së Shqipërisë me një sipërfaqe prej 616.85 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 135,009 banorësh sipas Censit 2023 dhe 207922 banorë sipas Gjendjes Civile. Bashkia ka në administrim 1 (një) qytet dhe 37 fshatra dhe përbëhet nga 4 (katër) njësi administrative: Njësia Administrative Oriku, Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Në qendër të vizionit të Bashkisë Vlorë qëndron zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, i orientuar drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve. Strategjia e zhvillimit vendor synon përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe rrugore, modernizimin e shërbimeve publike, nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja, si dhe mbështetjen e sipërmarrjes dhe prodhimit lokal.

E DHËNA	Viti 2025
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë (Gjendja Civile)	207922
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë (sipas MF)	135009
Popullsia në qytet (Gjendja Civile)	149775
Popullsia në njësitë administrative (Gjendja Civile)	58147
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km <sup>2</sup> )	616.85
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	3847.65
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	10777.65
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	18000
Numri total i njësive administrative të bashkisë	4
Numri i fshatrave	37
Punonjës të bashkisë në total	1480
Numri total i punonjëseve femra të bashkisë	764
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	716



BASHKIA VLORË

## Sfidat kryesore të Bashkisë Vlorë

Në qendër të vizionit të Bashkisë Vlorë qëndron zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, ky zhvillim nuk konceptohet vetëm përmes investimeve infrastrukturore, por edhe përmes rritjes së mirëqenies sociale, aksesit në shërbime cilësore dhe krijimit të mundësive të reja ekonomike për komunitetin. Bashkia Vlorë përballlet me një sërë sfidash që ndikojnë në ritmin e zhvillimit ekonomik, social dhe institucional. Adresimi i tyre mbetet thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

### 1. Sfidat ekonomike

- Varësia e lartë nga turizmi sezonal, duke krijuar luhatje të të ardhurave dhe punësimit gjatë vitit.
- Mungesa e diversifikimit ekonomik dhe zhvillimit të industrive prodhuese apo teknologjike.
- Nevoja për rritjen e investimeve private dhe publike në zonat rurale të bashkisë.

### 2. Sfidat sociale dhe demografike

- Emigrimi i të rinjve dhe ulja graduale e popullsisë aktive për punë.
- Plakja e popullsisë në zonat rurale.
- Nevoja për zgjerim të shërbimeve sociale për shtresat në nevojë dhe familjet vulnerabël.
- Rritja sezonale e popullsisë gjatë verës, duke shtuar presionin mbi shërbimet publike.
- Nevoja për më shumë hapësira rekreative, sportive dhe kulturore për komunitetin.

### 3. Sfidat infrastrukturore

- Ngarkesa e lartë në rrjetin rrugor urban gjatë sezonit turistik.
- Nevoja për rehabilitim dhe mirëmbajtje të rrugëve rurale dhe infrastrukturës lidhëse.
- Zgjerimi i shpejtë urban, që kërkon investime të vazhdueshme në ndriçim publik, trotuare dhe hapësira publike.
- Nevoja për menaxhim më eficient të parkimeve publike dhe transportit urban.

### 4. Sfidat mjedisore

- Rritja e volumit të mbetjeve urbane, veçanërisht gjatë sezonit turistik.
- Ndotja e vijës bregdetare dhe presioni mbi ekosistemet natyrore.
- Rreziku nga zjarret në pyje dhe degradimi i sipërfaqeve pyjore e kullimore.
- Ndikimet e ndryshimeve klimatike, përfshirë erozionin bregdetar dhe fenomenet ekstreme atmosferike.
- Nevoja për rritjen e riciklimit, gjelbërimit urban dhe ndërgjegjësimit mjedisor.



BASHKIA VLORE

## 5. Sfidat e qeverisjes vendore në Vlorë

- Rritja e kërkesës së qytetarëve për shërbime publike më cilësore dhe më të shpejta.
- Nevoja për forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në administrimin vendor.
- Vështirësi në menaxhimin dhe monitorimin e zhvillimit urban dhe ndërtimeve informale.
- Digjitalizimi i shërbimeve publike dhe përmirësimi i aksesit online për qytetarët.
- Përfshirja më e madhe e komunitetit dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse.
- Nevoja për forcimin e kontrollit të brendshëm, monitorimit të performancës dhe planifikimit strategjik afatgjatë.



BASHKIA VLORE

## Kategoria: Shërbimet

Monitorimi i performancës së shërbimeve është një funksion thelbësor për të siguruar cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ndihmon në vlerësimin e mënyrës se si bashkia përmbush përgjegjësitë e saj ndaj qytetarëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Përpara shfaqjes së treguesve të një raporti performance, është e rëndësishme të theksohet se monitorimi i shërbimeve nuk kufizohet vetëm në matjen e rezultateve, por përfshin edhe analizën e burimeve të përdorura, procedurave të ndjekura dhe ndikimit real që shërbimet kanë tek komuniteti.

Kjo kategori mbulon disa fusha të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve vendore, të cilat lidhen me cilësinë, efikasitetin dhe kënaqësinë e qytetarëve. Vlerësimi i tyre mundëson identifikimin e pikave të forta, sfidave dhe hapësirave për përmirësim në menaxhimin e shërbimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori do të ndihmojnë në kuptimin e performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve dhe do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje më të informuar dhe orientim drejt rezultateve më të mira për qytetarët.



BASHKIA VLORË

## ARSIMI BAZË PËRFSHIRË ARSIMIN PARASHKOLLOR

*Arsimi parashkollor u transferua në vitin 2016. Ligji 139/2015, i ndryshuar përcakton se bashkitë janë përgjegjëse kryesisht për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave për arsimin parauniversitar, përveç shkollave profesionale, si dhe për administrimin dhe rregullimin e arsimit parashkollor publik, kopshtet. Shumë aspekte të këtij shërbimi trajtohen në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Ky funksion nuk është financiar mjaftueshëm, duke ndikuar në cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit. Gjendja e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur tre tregues kryesorë: normat e regjistrimit të arsimit parashkollor për fëmijët deri në 6 vjeç, niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore dhe raporti fëmijë-mësues.*



Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.



BASHKIA VLORË

### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Raporti fëmijë/edukator në kopshte publike	fëmijë/edukator	Numri i fëmijëve për çdo edukator në kopshte publike	10.6	10	9.19
Raporti fëmijë/klasë në kopshtet publike	fëmijë/klasë	Numri mesatar i fëmijëve në një klasë në kopshtet publike	15.4	15	14
Kopshtet publike ku janë ngritur këshillat e prindërve	%	Kopshte ku janë ngritur këshillat e prindërve kundrejt numrit total të kopshteve publike	100	100	100
Raporti mësues mbështetës/fëmijë me AK	mësues/fëmijë	Numri i mësuesve mbështetëse kundrejt numrit të fëmijëve me AK	0.95	0.97	1
Shkalla e regjistrimit në sistemin parashkollor	%	Numri i fëmijëve të regjistruar në parashkollor kundrejt numrit total të fëmijëve në %	62.80	58	61.20

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç rezidentë në Bashki	numër			3540	3600	3250



BASHKIA VLORË

Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	numër	869	837	816	876	801
Numri i fëmijëve <b>djem</b> në moshën 5-6 vjeç	numër	590	497	456	440	381
Numri i fëmijëve <b>vajza</b> në moshën 5-6 vjeç	numër	279	340	360	436	420
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	2453	2281	2225	2101	1922
Numri i fëmijëve <b>djem</b> të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	1257	1169	1137	1101	937
Numri i fëmijëve <b>vajza</b> të regjistruara në sistemin parashkollor	numër	1196	1112	1088	1000	985
Klasa në sistemin parashkollor	numër	166	149	144	140	137
Numri i edukatorëve në sistemin e arsimit parashkollor	numër	180	180	209	210	209
Numri total i godinave të kopshteve	numër	45	42	42	42	42
Eduktorë të kualifikuar/trajnuar	numër	180	180	209	210	209
Numri total i godinave të kopshteve	numër	45	42	42	42	42
Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale	numër	48	45	45	45	45
Numri i kopshteve ku është ngritur bordi i kopshtit	numër	45	42	42	42	42
Numri i kopshteve ku është ngritur këshilli i prindërve	numër	45	42	42	42	42
Aktivite sensibilizuese për rëndësinë e shkollës dhe arsimit parashkollor	numër	3	3	4	5	7
Nxënës të regjistruar në sistemin arsimor bazë (9-vjeçar)	numër	8646	8176	7697	7450	7228
Nxënës <b>meshkuj</b> të regjistruar në sistemin bazë	numër	4461	4232	3954	3810	3698




BASHKIA VLORË

Nxënëse <b>femra</b> të regjistruara në arsimin bazë	numër	4185	3944	3743	3640	3530
Staf mbështetës në arsimin bazë	numër	56	56	56	56	56
Numri i mësuesve në arsimin bazë	numër	693	838	813	808	798
Klasa në sistemin e arsimit bazë	numër	449	457	450	437	354

Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor*

Gjatë vitit 2025 konstatohet rritje e shkallës së regjistrimit në arsimin parashkollor krahasuar me vitin 2024 (nga 58% në 61.2%). Megjithatë, treguesi mbetet akoma nën nivelin e vitit 2023 (62.8%), si dhe në terma absolutë, numri i fëmijëve të regjistruar në vitin 2025 ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2023, me rreth 13.6%. Kjo situatë pasqyron fenomenin më të gjerë demografik: Bashkia Vlorë ka shënuar ulje të popullsisë fëmijërore të moshës 3–6 vjeç nga 3,540 në 2023 në 3,250 në 2025, si pasojë e emigracionit dhe rënies së lindshmrisë. Në këto kushte, ruajtja e shkallës së regjistrimit më të lartë se 60% përfaqëson arritje relative.






BASHKIA VLORË

- *Numri i edukatorëve në sistemin e arsimit parashkollor*

Ulja graduale e raportit fëmijë/edukator nga 10.6 në vitin 2023 në 9.19 në vitin 2025 përfaqëson një përmirësim të ndjeshëm të standardeve pedagogjike në kopshtet publike. Ky tregues nënkupton se edukatorët disponojnë më shumë kohë dhe vëmendje për secilin fëmijë, duke ndikuar pozitivisht në zhvillimin individual kognitiv, emocional dhe social të fëmijëve të moshës parashkollore.




- *Numri i mësueseve mbështetëse*

Bashkia Vlorë ka treguar një kujdes të vazhdueshëm për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet parashkollore. Bashkia Vlorë është e **vetmja bashki në rang kombëtar që ka raportin 1:1, një fëmijë për një mësues ndihmës**. Numri i mësueseve ndihmëse në kopshtet publike të Bashkisë Vlorë është rritur në mënyrë të njëtrajtshme me numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Aftësia e kufizuar dhe integrimi i fëmijëve në institucionet arsimore po merr prioritet në Shqipëri. Ndhimja e herët për fëmijët me aftësi të kufizuara është një faktor kyç në zhvillimin sa më të mirë të fëmijës dhe përmirësimin e aftësive intelektuale, aspektin social dhe emocional, pavarësinë praktike dhe fushën e njohjes. Gjithnjë e më shumë prindërit po ndërjegjësohen dhe fëmijët po marrin diagnozën dhe shërbimin e duhur. Fushatat sensibilizuese në nivel lokal e kombëtar dhe emancipimi i vazhdueshëm i shoqërisë shqiptare, po e bën gjithnjë e më të lehtë pranimin e realitetit dhe njohjen e aftësisë së kufizuar si pjesë e shoqërisë. Kujdesi i treguar nga Bashkia Vlorë përbën një hap pozitiv drejt integritit, por vërehet gjithashtu edhe domosdoshmëria për përmirësimin e infrastrukturës për aksesueshmëri fizike dhe pajisje ndihmëse. Kopshtet që janë të pajisur me rampa për fëmijët me aftësi të kufizuara janë vetëm 3, ndërsa kopshtet e pajisur me tualete për fëmijë me aftësi të kufizuara 1. Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen e mësueseve mbështetëse dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë viteve 2021-2025.



BASHKIA VLORË



- *Analiza e të dhënave të arsimit bazë*

Numri i nxënësve të regjistruar në arsimin bazë (9-vjeçar) ka shënuar rënie të vazhdueshme gjatë periudhës 2021–2025, duke kaluar nga 8,646 në 7,228 nxënës — ulje prej rreth 16.4%. Kjo prirje lidhet kryesisht me faktorë demografikë: emigracionin e familjeve dhe rënien e lindshmërisë në nivel kombëtar. Megjithatë, numri i mësuesve është ruajtur relativisht i qëndrueshem (nga 693 në 2021 në 798 në 2025), gjë që ka ndikuar pozitivisht në ruajtjen e raportit nxënës/mësues dhe në gjenerimin e kushteve më cilësore të mësimdhënies.

Njëkohësisht, numri i klasave në arsimin bazë ka pësuar ulje të ndjeshme, nga 449 klasa në vitin 2021 në 354 klasa në vitin 2025, ose rreth 21.2% më pak. Kjo tendencë lidhet kryesisht me rënien e numrit të nxënësve dhe nevojën për optimizimin e kapaciteteve ekzistuese përmes bashkimit të klasave. Megjithatë, ky zhvillim meriton analizë të veçantë, pasi mund të ketë ndikim në organizimin e procesit mësimor, në madhësinë e klasave dhe në aksesueshmërinë e shërbimit arsimor, veçanërisht për nxënësit e zonave rurale, të cilët mund të përballen me distanca më të mëdha për të ndjekur shkollën.



BASHKIA VLORE

Arsimi parashkollor në Bashkinë Vlorë mbetet një prioritet thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe përgatitjen e brezave të rinj. Përmes investimeve në infrastrukturë, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mbështetjes sociale, synohet krijimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor. Angazhimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe aktorëve lokalë do të garantojë përmirësim të mëtejshëm dhe rezultate konkrete në të ardhmen.


Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rikonstruksion dhe mirëmbajtje periodike e shkollave dhe kopshteve;</li><li>• Funksionimi i kopshteve me dhe pa ushqim në territorin e bashkisë;</li><li>• Ruajtje e raportit 1:1 mësues mbështetës/fëmijë me aftësi ndryshe.</li><li>• Zbatim i skemave të bursave dhe librave falas për nxënësit në nevojë.</li><li>• Organizim aktivitetesh sportive, kulturore dhe edukative në bashkëpunim me institucionet lokale.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Amortizimi i godinave ekzistuese, veçanërisht në zonat rurale dhe nevoja për eficiencë energjetike.</li><li>• Kapacitete të kufizuara në disa zona urbane.</li><li>• Rritja e rasteve sociale dhe nevoja për mbështetje më të gjerë ekonomike</li><li>• Ulja e numrit të nxënësve për shkak të emigracionit dhe rënies së lindshmërisë.</li><li>• Mungesë e hapësirave multifunksionale në disa shkolla.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rikonstruksioni i plotë i institucioneve prioritare.</li><li>• Zgjerimi i aksesit në arsimin parashkollor dhe rritja e standardeve të shërbimit.</li><li>• Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe modernizimi i klasave dhe laboratorëve.</li><li>• Zhvillimi i shkollave si qendra komunitare.</li><li>• Rritja e përfshirjes së nxënësve dhe ulja e braktisjes shkollore.</li><li>• Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor Parauniversitar.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM

*Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve dhe ndërtesave të arsimit të mesëm të përgjithshëm, duke përfshirë shkollat profesionale, si dhe shpenzimet për pagat e stafit mbështetës. Kjo përfshin gjithashtu administrimin, organizimin e inspektimit të shërbimeve në konvikte, për strehimin dhe ofrimin e vakteve ushqimore për nxënësit.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Raporti nxënës/klasë në arsimin e mesëm	nxënës/klasë	Numri i nxënësve në arsimin e mesëm kundrejt numrit të klasave	23.3	23.4	23.3
Mbështetja me bursa në arsimin e mesëm	numër	Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional të mbështetur me bursë	40	62	75



BASHKIA VLORE

Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po=1 Jo=0	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar i miratuar	0	0	0
---------------------------------------	--------------	---------------------------------------------------	---	---	---

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit bazë (9-vjeçar)	numër		997	889	883	882
Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm	numër	2243	2266	2170	2086	2101
Nxënës <b>meshkuj</b> të regjistruar në sistemin e mesëm arsimor	numër	1028	1035	990	929	964
Nxënëse <b>femra</b> të regjistruara në sistemin e arsimit të mesëm	numër	1215	1231	1180	1157	1137
Klasa në sistemin e arsimit të mesëm	numër	95	90	93	89	90
Mësues në sistemin e arsimit të mesëm	numër	182	205	194	185	200
Numri i konvikteve	numër	1	1	1	1	1
Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte	numër	65	60	50	40	35
Nxënëse <b>femra</b> të akomoduar në konvikte	numër	4	4	3	2	2
Nxënës <b>meshkuj</b> të akomoduar në konvikte	numër	50	60	48	37	33
Numri i dhomave të konvikteve	numër	34	34	34	34	34
Numri i nxënësve që përfitojnë bursë	numër	38	33	22	20	19



BASHKIA VLORE

## MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

*Shërbimi i ujitje-kullimit, i cili përfshin mirëmbajtjen e kanaleve dytësore dhe tretësore, iu transferua bashkive në vitin 2016. Gjatë këtyre viteve është synuar përmirësimi i këtij shërbimi duke investuar në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, për të ardhur në ndihmë të fermerëve dhe ekonomive vendore. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin ose organizimin e sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, si dhe administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.



BASHKIA VLORË

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje dhe kullimi	%	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje dhe kullimi kundrejt sipërfaqes totale të tokës bujqësore në %	60.20	60.20	60.20
Kanale ujitjeje dhe kullimi funksionale	%	Raporti i kanaleve funksionale kundrejt totalit të kanaleve të ujitjes dhe kullimit në %	44.90	44.90	44.90

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Sipërfaqja e tokës bujqësore	ha	18000	18000	18000	18000	18000
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues	ha	10100	10100	10100	10100	10100
Siperfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës	ha	750	750	750	750	750
Rrjet kullues në pronësi të Bashkisë në total	km	441	441	351.7	351.7	351.7
Rrjet ujitës në pronësi të Bashkisë në total	km	628.4	628.4	628.4	628.4	628.4
Kanale ujitëse dhe kulluese të pastruara/mirëmbajtura	km	69.35	69.35	58.44	42.52	16.21
Numri i stafit të programit	numër	17	17	17	17	19

Menaxhimi i sistemeve të ujitjes dhe kullimit në Bashkinë Vlorë fokusohet në rritjen e eficiencës hidrike të rrjetit, përmes ndërhyrjeve në kanalet sekondare dhe terciare, pastrimit periodik dhe



BASHKIA VLORE

rehabilitimit të segmenteve të amortizuara të strukturave ekzistuese. Prioritet mbetet optimizimi i shpërndarjes së ujit për përdorim bujqësor dhe reduktimi i riskut nga përmytjet nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve kulluese.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi i funksionimit të rrjetit kullues në zonat me risk të lartë përmytjeje.</li><li>• Pastrimi dhe rehabilitimi periodik i kanaleve ujitëse dhe kulluese.</li><li>• Ndërhyrje në hidrovore dhe infrastruktura mbrojtëse ndaj përmytjeje.</li><li>• Përmirësimi gradual i kapaciteteve për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Amortizimi i një pjese të konsiderueshme të rrjetit ekzistues kullues dhe ujitës.</li><li>• Bllokimi i kanaleve nga inertet dhe mbetjet urbane.</li><li>• Risku i lartë i përmytjeje në periudha reshesh intensive.</li><li>• Garantimi i mirëmbajtjes së vazhdueshme të kanaleve sekondare dhe terciare.</li><li>• Nevoja për koordinim më të mirë ndërinstytucional për menaxhim të burimeve ujore.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit kullues dhe ujitës në të gjitha njësitë administrative.</li><li>• Zgjerimi i ndërhyrjeve në kanalet kulluese dhe ujitëse në zonat Novoselë, Akërnë, Llakatund, Risili dhe Bunavi.</li><li>• Rehabilitimi i hidrovoreve dhe veprave mbrojtëse.</li><li>• Rritja e sipërfaqeve bujqësore të mbuluara me shërbim ujitjeje.</li><li>• Sigurimi i mirëmbajtjes periodike të kanaleve kulluese dhe ujitëse dhe ulja e riskut të përmytjeje në zonat problematike.</li></ul>



BASHKIA VLORE

## ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

*Pas zbatimit të Reformës Administrative-Territoriale, bashkive në Shqipëri iu ngarkua përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura. Ky ndryshim synon forcimin e rolit të qeverisjes vendore në menaxhimin e burimeve natyrore, rritjen e përgjegjshmërisë, si dhe ofrim më të madh të shërbimeve pranë komuniteteve. Përmes këtij procesi, bashkitë marrin një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e këtyre pasurive natyrore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve. Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e administrimit të shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullorore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mbikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e liçencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrolle të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.



BASHKIA VLORË

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Pajisja me Plane Mbarështimi	Po=1 Jo=0	Ekzistenca e Planeve të miratuar të Mbarështimit	1	1	1
Plane Vendor Mbarështimi të miratuar	numër	Totali i Planeve vendore të Mbarështimit të miratuar	1	1	1
Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	Sipërfaqja e mbuluar me Plan Mbarështimi kundrejt sipërfaqes totale të fondit pyjor dhe kullosor	5.4	5.4	5.4
Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/ 1000 ha	Raporti i numrit të punonjësve për vitin e raportimit kundrejt sipërfaqes totale të fondit, për 1000 ha	0.98	1.2	1.2

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor	ha	11201	11201	11201	10777.65	10777.65
Sipërfaqe totale fondit kullosor	ha	7149	7149	7149	6930	6930
Sipërfaqe totale e fondit pyjor	ha	4052	4052	4052	3847.65	3847.65
Numri i punonjësve për menaxhimin pyjeve dhe kullotave	numër	7	8	11	13	13
Numri i punonjësve të administrimit të pyjeve të trajnuar	numër	1	0	1	2	0
Plan menaxhimi per fondin pyjor/kullosor	numër	0	0	1	1	1




BASHKIA VLORË

Aktivite sensibilizuese për mbrojtjen dhe rëndësinë e pyjeve	numër	5	5	6	7	7
Sipërfaqe pyjore në të cilën është shtuar pyllëzimi	ha	0	0.3	0	0	0.3
Numri i pemëve të reja të mbjella në fondin pyjor në vit	numër	0	900	0	0	400

Më poshtë paraqiten treguesit, të shoqëruara me grafikun përkatës.

- *Punonjës për 1000 hektarë*

Të dhënat për periudhën 2021–2025 tregojnë një rritje të numrit të punonjësve në administrimin e pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Vlorë, duke arritur në 13 punonjës në vitet 2024–2025. Edhe treguesi i punonjësve për 1000 ha pyje dhe kullota ka shënuar përmirësim të vazhdueshëm, nga 0.62 në vitin 2021 në 1.2 në vitin 2024. Kjo tregon forcim të kapaciteteve për menaxhimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave, në përputhje me standardet e parashikuara në ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.



Fokusi i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave ka qenë në ruajtjen e ekosistemeve natyrore, parandalimin e dëmtimeve në pyje dhe përmirësimin e përdorimit të sipërfaqeve kullimore. Ndryshimet klimatike dhe periudhat e zgjatura të thatësirës kanë rritur ndjeshëm riskun për degradimin e pyjeve dhe përhapjen e zjarreve, duke kërkuar ndërhyrje më të specializuara dhe



BASHKIA VLORË

investime afatgjata në mbrojtjen e territorit. Përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të mbarështimit Bashkia Vlorë synon zgjerimin e ndërhyrjeve për rehabilitimin e sipërfaqeve të dëmtuara, rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për mbrojtjen e pyjeve dhe përmirësimin e menaxhimit të territorit në përputhje me politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Monitorimi dhe administrimi i fondit pyjor dhe kullësor në territorin e bashkisë.</li><li>• Pastrimi i sipërfaqeve pyjore dhe ndërhyrje për reduktimin e riskut nga zjarret.</li><li>• Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe emergjencat civile.</li><li>• Ndërhyrje rehabilituese dhe ripyllëzime në zona të dëmtuara.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Risku i lartë nga zjarret gjatë sezonit të verës.</li><li>• Prerjet dhe dëmtimet e paligjshme në fondin pyjor.</li><li>• Erozioni i tokës dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike.</li><li>• Kufizimet financiare për investime rehabilituese dhe ripyllëzime masive.</li><li>• Degradimi i sipërfaqeve pyjore dhe kullësore në disa zona.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e sipërfaqeve të rehabilituara dhe të ripyllëzuara.</li><li>• Përmirësimi i menaxhimit të kullotave dhe mbështetja e sektorit blegtoral.</li><li>• Hartimi dhe zbatimi i planeve të mbarështimit për fondin pyjor.</li><li>• Zhvillimi i projekteve mjedisore dhe investimeve për mbrojtjen e biodiversitetit.</li></ul>



BASHKIA VLORE

## MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE

*Funksioni i menaxhimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi iu transferua Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në vitin 2016. Në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale, deri në fund të vitit 2018 u ngritën stacionet zjarrfikëse në çdo bashki, secili me një strukturë minimale prej 14 punonjësish. Bashkia është përgjegjëse për të siguruar funksionimin e njësive zjarrfikëse dhe shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj, si dhe rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe ndërgjegjësimin në komunitet përmes programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.



BASHKIA VLORE

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Rritja e kapaciteteve të punonjësve zjarrfikës	%	Numri i zjarrfikësve të trajnuar kundrejt numrit total të zjarrfikësve	7.31	7.31	5.1
Numri i zjarrfikësve për 1500 banorë	zjarrfikës/1500 banorë	Raporti i numrit të zjarrfikësve kundrejt numrit të popullsisë* për 1500 banorë	0.45	0.45	0.43

\*sipas MF

### Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Numri total i popullsisë (sipas ZGJC)	numër	203561	205339	205931	206921	207922
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	numër	35	41	42	42	41
Numri i punonjësve të MZSH <b>Meshkuj</b>	numër	34	40	41	41	40
Numri i punonjësve të MZSH <b>Femra</b>	numër	1	1	1	1	1
Zjarrfikës në dispozicion	numër	34	40	41	41	39
Zjarrfikës të trajnuar	numër	2	6	3	3	2
Numri i stacioneve të MZSH	numër	2	2	2	2	2
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin nga MZSH	numër	819	833	720	1056	882
Familje të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore të shpërblyera	numër	9	0	0	352	3



BASHKIA VLORË

Familje të dëmtuara nga zjarri të dëmshpërblyera	numër	9	9	12	13	15
Koha e daljes nga stacioni (mesatarja ditën dhe natën)	sekonda	50	50	50	50	50

Për vitin 2025, Bashkia Vlorë vijon të ketë dy stacione zjarrfikëse funksionale, numër i pandryshuar krahasuar me vitin e mëparshëm. Një stacion mbulon qytetin e Vlorës dhe njësitë administrative, ndërsa stacioni i dytë (i përkohshëm) ndodhet në Njësinë Administrative Orikum, pranë Tunelit të Llogarasë, duke mbuluar një zonë me rëndësi të veçantë për shkak të fluksit turistik dhe distancës nga qyteti.

Numri i efektivëve zjarrfikës për vitin 2025 është 39 punonjës, kundrejt 41 punonjësve në vitin 2024, ndërsa sektori disponon 7 mjete zjarrfikëse për përballimin e emergjencave dhe ndërhyrjeve operative. Pavarësisht uljes së lehtë të numrit të punonjësve, sektori vijon të mbetet një strukturë e rëndësishme për garantimin e sigurisë publike, veçanërisht gjatë sezonit veror, kur rritet rreziku i zjarreve dhe emergjencave në territorin e Bashkisë Vlorë.

Duke marrë në konsideratë numrin e popullsisë së Bashkisë Vlorë dhe standardin e parashikuar prej 1 zjarrfikësi për 1500 banorë, evidentohet nevoja për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Aktualisht, drejtoria ushtron funksionet e saj me 39 efektivë zjarrfikës, ndërkohë që Bashkia po punon gradualisht për përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe operacionale të këtij shërbimi. Në këtë kuadër, rëndësi e veçantë po i kushtohet trajnimit dhe kualifikimit të vazhdueshëm të stafit, me qëllim rritjen e eficiencës në menaxhimin e emergjencave, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e një reagimi sa më të shpejtë dhe profesional ndaj situatave të riskut.


Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikun përkatës.

- ***Familje të dëmtuara nga zjarri të dëmshpërblyera***

Të dhënat për vitet 2021–2025 tregojnë se numri i rasteve të zjarreve të menaxhuara nga MZSH në Bashkinë Vlorë ka pasur luhajtje ndër vite, ndikuar nga faktorët atmosferik dhe papërgjegjshmëria e qytetarëve. Paralelisht, është rritur numri i familjeve të dëmshpërblyera nga zjarret, nga 9 familje në vitet 2021–2022 në 12 familje në vitin 2023, 13 në vitin 2024 dhe 15 familje në vitin 2025. Kjo tregon një angazhim të vazhdueshëm të bashkisë për të mbështetur familjet e prekura dhe për të përballuar pasojat e rasteve të zjarreve.



BASHKIA VLORË



Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi në Bashkinë Vlorë synon të rrisë kapacitetet operacionale përmes modernizimit të flotës, trajnimit të personelit dhe përmirësimit të kohës së reagimit. Gjithashtu synohet edhe zgjerimi i mbulimit territorial të shërbimit zjarrfikës, rritja e investimeve në teknologji dhe pajisje moderne, si dhe forcimi i rolit të mbrojtjes civile në përballimin e emergjencave natyrore dhe mjedisore. Një sfidë e rëndësishme mbetet edhe ndërgjegjësimi qytetar për respektimin e rregullave të sigurisë dhe parandalimin e zjarreve.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ndërhyrje të shpejta dhe efektive në raste zjarresh.</li><li>• Menaxhimi i situatave emergjente gjatë sezonit veror, veçanërisht në zonat me risk të lartë për zjarre.</li><li>• Rritja e ndërgjegjësimit qytetar për parandalimin e zjarreve.</li><li>• Kryerja e kontrolleve dhe inspektimeve për masat e mbrojtjes nga zjarri.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Nevoja për rinovim të mëtejshëm të flotës zjarrfikëse dhe pajisjeve teknike.</li><li>• Rritja e ngarkesës operacionale gjatë sezonit turistik.</li><li>• Vështirësitë e aksesit në zona malore dhe rurale gjatë emergjencave.</li><li>• Risku i lartë nga ndërhyrjet e paligjshme dhe djegiet e pakontrolluara.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritje e numrit të mjeteve dhe modernizimi i flotës zjarrfikëse dhe pajisjeve operacionale.</li><li>• Rritja e kapaciteteve profesionale të personelit zjarrfikës.</li><li>• Zgjerimi i mbulimit territorial të shërbimit zjarrfikës.</li><li>• Hartimi dhe përditësimi i planeve të emergjencës dhe menaxhimit të riskut.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## MENAXHIMI I MBETJEVE

*Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar, bashkitë kanë detyrimin për administrim, mbikëqyrjen, inspektimin, organizimin ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake, administrimin e granteve, huave ose financimeve për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve, pastrimin e rrugëve, parqeveve etj. Ky funksion përfaqëson një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të bashkisë, me ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në cilësinë e jetës së qytetarëve.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Pajisja me Plan Vendor për Menaxhimin e Mbetjeve	Po=1 Jo=0	Ekzistenca e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve	1	1	1
Mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	%	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane dhe rurale	100	100	100



BASHKIA VLORË

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

<b>E dhëna</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Numri total i popullsisë	numër	203561	205339	205931	206921	207922
Sipërfaqja gjithsej e bashkisë	km <sup>2</sup>	616.85	616.85	616.85	616.85	616.85
Sipërfaqja e pastruar	m <sup>2</sup>	800000	800000	800000	800000	800000
Numri i popullsisë në zonën urbane	numër	145562	147410	147989	148800	149775
Numri i përgjithshëm i popullsisë në zonën rurale	numër	57999	57929	57942	58121	58147
Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	203561	205339	205931	206921	207922
Numri i popullsisë në zonën urbane e mbuluar me shërbim e menaxhimit të mbetjeve	numër	145562	147410	147989	148800	149775
Numri i popullsisë në zonën rurale e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	57999	57929	57942	58121	58147
Depozitimi i mbetjeve ne vende me leje mjedisore	PO = 1, JO= 0	1	1	1	1	1
Sipërfaqe e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	km <sup>2</sup>	616.85	616.85	616.85	616.85	616.85
Sasia totale e mbetjeve urbane	ton	70000	70000	60000	65700	67634.5
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në qytet	ton	51000	51000	45000	45000	52634.5
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në NJA	ton	21000	21000	15000	15000	15000
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane	herë në javë	5	5	5	5	5




BASHKIA VLORË

Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane	herë në javë	7	7	7	7	7
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në NJA	herë në javë	3	3	3	3	3

Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikun përkatës.

- *Sasia totale e mbetjeve urbane*

Të dhënat për vitet 2023–2025 tregojnë një rritje të sasisë së mbetjeve urbane të menaxhuara në Bashkinë Vlorë, nga 60,000 ton në vitin 2023 në 67,634.5 ton në vitin 2025. Kjo rritje lidhet jo vetëm me zgjerimin e aktivitetit urban, por edhe me shtimin e fluksit të turistëve gjatë gjithë vitit, duke reflektuar zhvillimin e Vlorës si një destinacion turistik aktiv në të gjitha sezonet. Shërbimi i grumbullimit dhe menaxhimit të mbetjeve ofrohet në të gjithë territorin e bashkisë, duke mbuluar të gjithë popullatën. Menaxhimi i kësaj sasive mbetjesh tregon angazhimin e vazhdueshëm të bashkisë për pastrimin e qytetit, ruajtjen e standardeve higjeno-sanitare dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës për qytetarët dhe vizitorët.



Menaxhimi i mbetjeve në Bashkinë Vlorë synon rritjen e eficiencës së shërbimit përmes optimizimit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve. Prioritet mbetet rritja e cilësisë së pastrimit, mbulimi më i gjerë territorial dhe përmirësimi i kushteve mjedisore në qytet dhe njësi administrative. Rëndësi të veçantë ka edhe përmirësimi i ndarjes në burim dhe rritja e shkallës së



BASHKIA VLORE

riciklimit, në përputhje me standardet mjedisore. Monitorimi i performancës së shërbimit dhe ndërgjegjësimit i komunitetit janë thelbësorë për garantimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Zgjerimi i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në zona urbane dhe rurale.</li><li>• Rritja e frekuencës së pastrimit në akset kryesore dhe zonat turistike.</li><li>• Vendosja dhe rinovimi i kontenierëve në pika problematike.</li><li>• Rritja e monitorimit për depozitimet e paligjshme të mbetjeve.</li><li>• Zbatim i Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e sasisë së mbetjeve gjatë sezonit turistik.</li><li>• Nevoja për rinovim dhe shtim të kontenierëve dhe mjeteve teknologjike.</li><li>• Niveli ende i ulët i ndarjes së mbetjeve në burim dhe riciklimit.</li><li>• Depozitimet e paligjshme të mbetjeve dhe inerteve në territor.</li><li>• Nevoja për rritje të ndërgjegjësimit qytetar për pastërtinë dhe mbrojtjen e mjedisit.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e eficiencës së shërbimit të pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve.</li><li>• Përmirësimi i infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve.</li><li>• Shtimi i investimeve në mjete dhe pajisje teknologjike.</li><li>• Nxitja e ndarjes së mbetjeve në burim dhe riciklimit.</li><li>• Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese për edukimin mjedisor.</li></ul>



BASHKIA VLORE

## PËRKUJDESI SOCIAL

*Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë. Shërbimi i mbrojtjes sociale përfshin dhënien e ndihmës ekonomike dhe mbështetjes në para ose në natyrë për familjet, fëmijët dhe personat në nevojë. Ky shërbim përfshin pagesa për familjet me fëmijë, mbështetje për persona me aftësi të kufizuara, ndihmë për familjet me të ardhura të ulëta, si dhe shërbime për persona në rrezik përjashtimi social, viktime të dhunës, emigrantë apo persona në kushte të vështira ekonomike. Ndihma ofrohet në forma të ndryshme, si mbështetje financiare, strehim, ushqim, këshillim dhe shërbime të tjera sociale. Ky funksion realizohet në bashkëpunim me pushtetin qendror dhe mbështetet nga fondet për ndihmën ekonomike dhe skemat e mbrojtjes shoqërore.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Pajisja me Plan Vendor Social	Po=1 Jo=0	Ekzistenca e Planit Vendor Social	0	1	1



BASHKIA VLORË

Familje që marrin ndihmë ekonomike	%	Numri i famlijeve që kanë përfituar ndihmë ekonomike kundrejt numrit të familjeve që kanë aplikuar	83	94	93
------------------------------------	---	----------------------------------------------------------------------------------------------------	----	----	----

**Të dhënat e shërbimit**

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Fëmijë të regjistruar në çerdhe	numër	56	66	82	78	84
Eduktorë në çerdhe	numër	8	8	9	9	9
Numri total i godinave të çerdheve	numër	3	3	3	3	3
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj - 3 vjeç rezident në territorin e bashkisë	numër			3200	3150	2950
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	2385	2281	2225	2101	1922
Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale	numër	45	45	45	45	45
Personeli i çerdhes i trajnuar për mirëqenien dhe shëndetin psikomotorr të fëmijës	numër	0	8	9	9	9
Fëmijë të shërbyer në qendra ditore	numër	16	104	60	50	63
Fëmijë të shërbyer gjithsej në qendrat sociale	numër	16	104	30	29	40
Numri i punonjësve të Kujdesit për Fëmijët dhe Familjet në nevojë	numër	8	8	11	11	11
Numri i shërbimeve të ofruara për PAK-të në shtëpi-familje	numër	4	4	4	4	4
Numri i femrave të mbështetur me pagesë invaliditeti	numër	2718	2623	1359	1236	715
Numri total i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike	numër	822	721	558	635	640
Viktima të dhunës në familje të asistuar	numër	228	150	60	90	97
Invalidë përfitues nga ndihma sociale	numër	103	76	73	88	63



BASHKIA VLORË

Fëmijë të shërbyer në Qendra rezidenciale	numër	70	80	49	57	29
Numri total i personave PAK që përfitojnë kujdesin social (Pagesë, trajtim në shtëpi, trajtim në qendra PAK)	numër	31	31	30	110	29
Numri i personave PAK të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale	numër	31	31	30	29	29

Bashkia Vlorë ka vijuar forcimin e politikave dhe shërbimeve të mbrojtjes sociale, duke synuar mbështetjen e shtresave në nevojë, përmirësimin e përfshirjes sociale dhe garantimin e aksesit në shërbime bazë për qytetarët vulnerabël. Bashkia Vlorë ka vijuar gjithashtu zbatimin e programeve për integrimin social dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbime sociale dhe komunitare. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes së fëmijëve, trajtimit të rasteve të dhunës dhe mbështetjes së familjeve në vështirësi ekonomike e sociale.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijët, të moshuarit dhe grupet vulnerabël.</li><li>• Zbatimi i programeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e dhunës në familje.</li><li>• Përmirësimi i identifikimit dhe referimit të rasteve në nevojë.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë dhe kufizimet financiare për mbulimin e plotë të nevojave sociale.</li><li>• Menaxhimi i rasteve komplekse të dhunës, abuzimit dhe mbrojtjes së fëmijëve.</li><li>• Integrimi social dhe ekonomik i grupeve vulnerabël dhe përmirësimi i aksesit në shërbime për zonat rurale dhe periferike.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e investimeve në shërbimet sociale.</li><li>• Rritja e mbështetjes për familjet dhe individët në nevojë.</li><li>• Forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve dhe parandalimin e dhunës.</li><li>• Përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve në qendrat sociale.</li></ul>



BASHKIA VLORE

## STREHIMI SOCIAL

*Shërbimi i strehimit social konsiston në ofrimin e përfitimeve në natyrë dhe në para për familjet dhe individët në nevojë, me qëllim ndihmën për të përballuar kostot e strehimit dhe për të ulur varfërinë. Ai përfshin ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social sipas ligjit, pagesa të përkohshme ose afatgjata për qiramarrësit, si dhe administrimin e çështjeve dhe shërbimeve të strehimit. Gjithashtu, përfshin promovimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive për zhvillimin e strehimit dhe ofrimin e mbështetjes financiare për grupet më vulnerabël për të lehtësuar situatat e vështira ekonomike.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Shkalla e miratimit të strehimit social	%	Numri i individëve që kanë përfitur strehim social kundrejt atyre që kanë aplikuar (banesa me kosto të ulët).	68	45	27



### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

<b>E dhëna</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Numri i familjeve përfituese për strehim social (banesa me kosto të ulët)	numër	66	62	113	77
Numri i familjeve përfituese nga suvencionimi i qirasë (cash për kontratë qiraje)	numër	60	43	39	54
Numri i familjeve <b>romë dhe egjiptianë</b> përfituese të suvencionimit të qirasë	numër	13	10	8	13
Numri i familjeve përfituese të përmirësimit të kushteve fizike të banesave	numër	6	8	6	23
Numri i familjeve <b>romë dhe egjiptianë</b> përfituese të përmirësimit të kushteve fizike të banesave	numër	4	3	2	8



Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Familjet përfituese nga bonuset sociale*

Gjatë viteve 2022–2025, Bashkia Vlorë ka treguar angazhim të vazhdueshëm në zbatimin e programeve sociale të strehimit, përmes banesave me kosto të ulët, suvencionimit të qirasë dhe përmirësimit të kushteve fizike të banesave. Këto programe kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e familjeve në vështirësi ekonomike dhe në garantimin e një strehimi më të sigurt dhe dinjtoz për shtresat vulnerabël. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar komuniteteve romë dhe egjiptiane, të cilat kanë përfituar rreth 22.3% të programit të suvencionimit të qirasë dhe 43% të programit për përmirësimin e kushteve të banesave. Kjo tregon përkushtimin e bashkisë për të nxitur përfshirjen sociale dhe për t'u krijuar mundësi strehimi edhe familjeve më në nevojë.



BASHKIA VLORË



Të dhënat mbi programet e strehimit social tregojnë se Bashkia ka vijuar të mbështesë familjet në nevojë përmes disa instrumenteve të strehimit, duke evidentuar përmirësime të dukshme në disa prej treguesve kryesorë gjatë vitit 2025. Kjo tregon një fokus më të madh të Bashkisë drejt përmirësimit të kushteve të jetesës për kategoritë më vulnerabël dhe përfshirjes sociale të komuniteteve në nevojë. Bashkia Vlorë synon të zgjerojë skemat e subvencionimit, rritjen e investimeve në banesa sociale, përmirësimin e kushteve të banimit dhe forcimin e politikave sociale gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e mbrojtjes sociale dhe zhvillimit të qëndrueshëm.



BASHKIA VLORE

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e numrit të familjeve përfituese nga përmirësimi i kushteve fizike të banesave.</li><li>• Rritja e mbështetjes për komunitetet rome dhe egjiptiane.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Sigurimi i fondeve dhe kapaciteteve të mjaftueshme për zgjerimin e programeve të strehimit social.</li><li>• Rritja e qëndrueshme e aksesit në strehimin social.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zgjerimi i skemave të strehimit social.</li><li>• Rritja e numrit të familjeve përfituese nga banesat me kosto të ulët.</li><li>• Rritja e mbështetjes financiare për subvencionimin e qirasë.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## POLICIA BASHKIAKE

*Ky shërbim siguron mbrojtjen, qetësinë dhe mbarëvajtjen e jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror. Ai përfshin gjithashtu ekzekutimin e akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit të Njësisë. Performanca e shërbimit vlerësohet përmes treguesve kryesorë: raporti në përqindje i ankesave dhe konflikteve të zgjidhura ndaj numrit të tyre total në polici, raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake ndaj numrit total të punonjësve të policisë bashkiake dhe raporti në përqindje i punonjësve të trajnuar ndaj numrit total të punonjësve.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Shkalla e zgjidhjeve të ankesave/konflikteve	%	Raporti ndërmjet ankesave/konflikteve që kanë marrë zgjidhje kundrejt totalit të raportuara pranë PB	97.18	88.89	96.42



BASHKIA VLORE

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

<b>E dhëna</b>	<b>Njësia Matëse</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Numri total i punonjësve të Policisë bashkiake	numër	35	35	35	48
Punonjës me statusin Oficer në Policinë Bashkiake	numër	1	1	1	1
Numri i punonjësve të Policisë Bashkiake të trajnuar	numër	12	0	0	0
Numri i grupeve të patrullimit të Policisë bashkiake	numër	8	8	8	14
Numri i rasteve të konflikteve/mosmarrëveshjeve të raportuara dhe regjistruara në Policinë bashkiake	numër	1690	1029	1350	1400
Raste konfliktesh/mosmarrëveshjes të zgjidhura nga Policia bashkiake	numër	665	1000	1200	1350
Numri i akteve administrative të ekzekutuara nga Policia bashkiake	numër	245	22	184	307


Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- ***Numri i grupeve të patrullimit të Policisë Bashkiake***

Të dhënat tregojnë se gjatë viteve 2022–2024 numri i grupeve të patrullimit ka qenë i qëndrueshëm, me nga 8 grupe çdo vit. Në vitin 2025 vihet re një rritje e ndjeshme, duke arritur në 14 grupe patrullimi. Kjo rritje tregon forcim të pranishëm të Policisë Bashkiake në territor dhe përmirësim të kapaciteteve për mbikëqyrjen, kontrollin dhe reagimin ndaj problematikave të komunitetit.




BASHKIA VLORË



- **Shkalla e zgjidhjes së konflikteve/mosmarrëveshjeve**

Treguesi paraqet përmirësim të ndjeshëm në punën që Policia Bashkiake ka bërë për zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve ndër vite. Në vitin 2025 janë raportuar 1400 raste konfliktesh dhe mosmarrëveshjesh, ndërsa 1350 prej tyre janë zgjidhur nga Policia Bashkiake. Kjo tregon një nivel shumë të lartë të zgjidhjes së rasteve dhe një angazhim të rëndësishëm të bashkisë për menaxhimin e problematikave në komunitet.



Policia Bashkiake në Bashkinë Vlorë ka në fokus forcimin e kontrollit në territor, përmirësimin e menaxhimit urban dhe rritjen e sigurisë dhe rendit publik. Synohet gjithashtu edhe konsolidimi i rolit të Policisë Bashkiake në administrimin e territorit, rritja e standardeve të shërbimit ndaj qytetarëve dhe integrimi më i gjerë i teknologjisë në monitorimin dhe menaxhimin e hapësirave publike.



BASHKIA VLORË

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e kontrolleve në territor për zënien e hapësirave publike.</li><li>• Ndërhyrje për lirim të trotuareve dhe akseve publike të zëna në mënyrë të paligjshme.</li><li>• Monitorimi i zbatimit të rregullave për tregtimin ambulant dhe aktivitetet në hapësirat publike.</li><li>• Rritja e prezencës së patrullave në zonat me fluks të lartë qytetarësh dhe vizitorësh.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zënia e paligjshme e hapësirave publike dhe trotuareve</li><li>• Menaxhimi i problematikave të parkimeve dhe qarkullimit urban.</li><li>• Rritja e fluksit të automjeteve dhe qytetarëve gjatë sezonit turistik.</li><li>• Tregtimi i paautorizuar në zona urbane dhe bregdetare.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Forcimi i masave kundër zënieve të paligjshme dhe tregtimit informal.</li><li>• Përmirësimi i reagimit ndaj problematikave urbane dhe ankesave qytetare.</li><li>• Përmirësimi i kontrollit mbi përdorimin e hapësirave publike.</li><li>• Forcimi i monitorimit për zbatimin e rregulloreve vendore dhe mbrojtjen e mjedisit urban.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## TRANSPORTI PUBLIK

*Ky shërbim përfshin kontraktimin e shoqërive private për sigurimin e transportit publik lokal, mbikëqyrjen dhe rregullimin e shërbimeve të tyre, përfshirë miratimin e tarifave, orareve dhe shpeshhtësisë së operacioneve. Ai përfshin gjithashtu prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi oraret dhe funksionimin e sistemit, si dhe dhënien e granteve, huave ose financimeve për mbështetjen, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit publik lokal.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.



BASHKIA VLORE

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i linjave të transportit publik urban dhe ndërurban	numër	30	30	28	28	28
Numri i linjave urbane të transportit publik	numër	8	8	6	6	6
Numri i linjave interurbane të transportit publik	numër	22	22	22	22	22
Numri i automjeteve të transportit publik urban dhe ndërurban	numër	83	83	85	85	80
Numri i automjeteve të transportit publik urban	numër	18	18	20	20	15
Numri i automjeteve të transportit publik ndërurban	numër	65	65	65	65	65
Numri i udhëtarëve në linjat urbane	numër	1916491	1,835,588	2,153,500	2,436,375	1,858,338
Bileta të transportit publik të shitura në vit	numër	1,700,491	1,619,588	1,668,050	1,950,925	1,557,081


Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikun përkatës.

- ***Numri i udhëtarëve dhe biletave të shitura në transportin publik urban***

Të dhënat tregojnë se transporti publik urban në Bashkinë Vlorë ka vijuar të përdoret në masë të gjerë gjatë viteve 2021–2025. Në vitin 2025, që është edhe viti i raportimit, janë regjistruar 1,858,338 udhëtarë në linjat urbane dhe janë shitur 1,557,081 bileta transporti publik, çka tregon se ky shërbim mbetet shumë i rëndësishëm për qytetarët dhe vizitorët. Megjithatë, ndërkohë që përdorimi i transportit publik vijon të jetë i lartë, numri i linjave urbane është ulur nga 8 linja në vitin 2022 në 6 linja në vitin 2025. Kjo tregon nevojën për shtimin e linjave dhe të automjeteve të transportit urban publik, për të përmirësuar aksesin, për të ulur mbingarkesën dhe për të ofruar një shërbim më cilësor gjatë gjithë vitit.



BASHKIA VLORË



Fokusi i Bashkisë Vlorë mbi shërbimin e transportit publik urban dhe ndërurban ka qenë i përqëndruar në rritjen e aksesueshmërisë, përmirësimin e lëvizshmërisë qytetare dhe menaxhimin më efikas të qarkullimit në territorin e bashkisë. Një sfidë e rëndësishme mbetet krijimi i një sistemi më efikas dhe të qëndrueshëm të transportit urban, që t'i përgjigjet zhvillimit të shpejtë urban dhe rritjes së numrit të vizitorëve në qytet. Objektivat e Bashkisë Vlorë në sektorin e transportit publik synojnë përmirësimin e lëvizshmërisë urbane dhe rritjen e cilësisë së shërbimit për qytetarët dhe vizitorët.



BASHKIA VLORË

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi gradual i infrastrukturës rrugore që mbështet transportin publik.</li><li>• Menaxhimi i qarkullimit gjatë sezonit turistik dhe periudhave me fluks të lartë.</li><li>• Ndërhyrje për sistemimin e stacioneve dhe pikave të qëndrimit.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e trafikut dhe mbingarkesa e akseve kryesore gjatë sezonit turistik.</li><li>• Nevoja për modernizimin e flotës së transportit publik.</li><li>• Vështirësitë në menaxhimin e parkimeve dhe qarkullimit urban.</li><li>• Krijimi i një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm të transportit urban.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Përmirësimi i cilësisë dhe eficiencës së transportit publik urban.</li><li>• Modernizimi gradual i flotës së transportit.</li><li>• Menaxhimi më efikas i trafikut urban dhe parkimeve.</li><li>• Hartimi i planeve afatgjata për mobilitetin urban dhe zhvillimin e transportit.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## MBËSHETJE PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

*Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të regjistrimit dhe liçensimit të bizneseve; Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe me biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik; Funksionimi ose mbështetja me politika v endore të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda njësisë; Mbështetje dhe promovim i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore ; Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitetet promovuese etj. Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj. Grante, hua ose subvencione për të promovuar politikat e përgjithshme dhe programet vendore ekonomike dhe tregtare për të nxitur punësimin.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Norma e krijimit të bizneseve të reja	%	Raporti i numrit të bizneseve të reja kundrejt numrit total të bizneseve	11.5	11.3	11.7



BASHKIA VLORË

Norma e mbylljes së bizneseve	%	Raporti i numrit të bizneseve të mbyllura kundrejt numrit total të bizneseve	7.6	6.3	5.9
Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra	%	Raporti i numrit të bizneseve të drejtuara nga gra kundrejt numrit total të bizneseve	6.9	6.8	7.02
Pesha e bizneseve agropërpunuese dhe të turizmit	%	Raporti i numrit të bizneseve agropërpunuese dhe të turizmit kundrejt numrit total të bizneseve	2.8	3.72	4.7

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

<b>E dhëna</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Numri i bizneseve aktive në territor	numër	7580	8432	9172
Numri i bizneseve të reja të regjistruara (në vit)	numër	874	955	1074
Numri i bizneseve të mbyllura (në vit)	numër	582	538	548
Numri i bizneseve të drejtuara nga gra	numër	524	573	644
Numri i bizneseve / agropërpunuese & turizmit	numër	216	314	431
Numri i turistëve të huaj (në qark/bashki)	numër	140430	156737	236618
Numri i strukturave akomoduese (hotele, B&B, bujtina)	numër	216	314	431
Numri i shtretërve në struktura akomoduese	numër	3016	5621	7548
Numri i atraksioneve turistike të inventarizuara	numër	75	75	75




BASHKIA VLORE

Numri i operatorëve turistikë/guideve të licencuar në territor	numër	16	24	31
Numri i eventeve kulturore/turistike në vit	numër	103	137	137
Numri i materialeve promocionale (broshura, faqe web, fushata)	numër	1000	1500	1500

Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikun përkatës.

- ***Pesha e bizneseve të drejtuara nga gra***

Vihet re një rritje graduale e përfshirjes së grave në aktivitetin ekonomik, e reflektuar në shtimin e lehtë të peshës së bizneseve të drejtuara prej tyre. Ky tregues dëshmon një pjesëmarrje më të madhe të grave në sipërmarrje dhe në drejtimin e aktiviteteve ekonomike lokale.




- ***Pesha e bizneseve të agropërpunimit dhe turizmit***

Nga analiza e treguesve rritja më e dukshme konstatohet në sektorët agropërpunues dhe të turizmit, ku pesha e bizneseve të këtij profili është rritur nga 2.8% në 4.7%, duke dëshmuar orientimin e ekonomisë lokale drejt sektorëve me potencial të lartë zhvillimi dhe ndikim të drejtpërdrejtë në punësim dhe ekonomi vendore.



BASHKIA VLORË



Analiza e treguesve ekonomikë dhe turistikë për periudhën 2023–2025 evidenton një trend pozitiv të zhvillimit vendor. Norma e krijimit të bizneseve të reja ka mbetur e qëndrueshme, ndërsa norma e mbylljes së tyre ka ardhur në ulje, duke treguar përmirësim të klimës ekonomike dhe rritje të qëndrueshmërisë së sipërmarrjes. Gjithashtu, vihet re rritje graduale e bizneseve të drejtuara nga gra dhe zgjerim i sektorëve të agropërpunimit dhe turizmit, të cilët po marrin një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në ekonominë lokale.

Paralelisht, sektori i turizmit ka shënuar rritje të konsiderueshme të numrit të turistëve të huaj, zgjerim të strukturave akomoduese dhe rritje të kapaciteteve pritëse. Shtimi i operatorëve turistikë, eventeve kulturore dhe materialeve promocionale reflekton forcimin e ofertës turistike dhe të promovimit të territorit. Në tërësi, treguesit dëshmojnë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe turistik, të mbështetur në rritjen e investimeve dhe të potencialit të territorit.

Zhvillimi ekonomik dhe mbështetja ndaj biznesit në Bashkinë Vlorë fokusohen në krijimin e një klime të favorshme për investime, përmes lehtësimit të procedurave administrative dhe përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse. Prioritet mbetet nxitja e sipërmarrjes vendase, formalizimi i aktiviteteve ekonomike dhe mbështetja e sektorëve me potencial, si turizmi dhe bujqësia. Përmes politikave të koordinuara synohet diversifikimi i ekonomisë lokale, mbështetja e sipërmarrjes dhe bizneseve të vogla, tërheqja e investimeve të reja, si dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe digjitalizimi i shërbimeve për biznesin.



BASHKIA VLORE

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e aktiviteteve ekonomike dhe zgjerimi i shërbimeve veçanërisht në sektorin e turizmit dhe tregtisë.</li><li>• Rritja e fluksit turistik dhe zgjerimi i aktivitetit ekonomik në zonat bregdetare.</li><li>• Promovim i potencialeve ekonomike dhe turistike të qytetit në aktivitete promovuese.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ekonomia sezonale dhe varësia e lartë nga turizmi veror.</li><li>• Presioni mbi infrastrukturën publike gjatë sezonit turistik.</li><li>• Konkurrenca me bashki të tjera për tërheqjen e investitorëve strategjikë.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Diversifikimi i ekonomisë lokale dhe nxitja e investimeve gjatë gjithë vitit.</li><li>• Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i standardeve të shërbimeve.</li><li>• Tërheqja e investimeve të reja në turizëm, shërbime, agro-përpunim dhe ekonomi detare.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARTISTIKE DHE KULTURORE

*Ky shërbim përfshin zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me këto funksione. Ai mbështet vendet historike, kopshte zoologjike dhe botanike, bibliotekat dhe ambientet për lexim, duke kontribuar në edukimin e përgjithshëm qytetar. Përfshihet gjithashtu mbështetja për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot dhe sallat e ekspozitave, organizimi i ngjarjeve kulturore si koncerte, prodhime skenike, filma dhe shfaqje artistike, si dhe sigurimi, administrimi, mbikëqyrja dhe rregullimi i strukturave dhe shërbimeve kulturore. Shërbimi synon gjithashtu organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar dhe lokal.*



### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
Numri i aktiviteteve kulturore për 1000 banorë	aktivitete/ 1000 banorë	Numri i aktiviteteve kulturore gjatë vitit të raportimit për kundrejt numrit total të popullsisë* për 1000 banorë	0.73	0.81	1.48



BASHKIA VLORË

Pjesmarrës në aktivitete kulturore	pjesmarrës/1000 banorë	Raporti i numrit të pjesëmarrësve në aktivitete kulturore kundrejt numrit të popullsisë, për 1000 banorë	102.8	111.4	128.3
Shpenzime për çdo banor	lekë/banor	Raporti i totalit të shpenzimeve për kulturë gjatë vitit të raportimit kundrejt numrit të popullsisë*	640	687	550

\*sipas MF

### ***Të dhënat e shërbimit***

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

<b>E dhëna</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Numri i stafit të programit	numër	13	13	14	14	30
Numri i punonjësve që mbulojnë objektet e trashëgimisë kulturore, muzetë dhe bibliotekat	numër	13	13	14	14	15
Numri i shfaqjeve kulturore, eventeve artistike të mbështetura me fondet e Bashkisë	numër	80	94	99	110	200
Bileta të shitura për eventet kulturore	numër	1456	1850	në rikonstruksion		1130
Shfaqje teatri	numër	10	18	36	59	60
Bileta të shitura në teatër	numër	1456	1238	2514	2365	1857



BASHKIA VLORË

Numri i aktiviteteve promovuese të vlerave të trashëgimisë kulturore, traditës, muzeut, etj.	numër	3	2	3	4	10
Të ardhurat nga muzetë, teatrot, eventet kulturore, kopshtet zoologjike, botanike	lekë	351,200	403,400	2355000	2,123,000	2,484,000
Libra të rinj në bibliotekë	numër	589	857	888	998	600


Më poshtë paraqiten të dhënat, të shoqëruara me grafikun përkatës.

- *Numri i shfaqjeve kulturore, eventeve artistike të mbështetura me fondet e Bashkisë*

Të dhënat tregojnë një rritje të vazhdueshme të numrit të shfaqjeve kulturore dhe eventeve artistike të mbështetura me fondet e Bashkisë Vlorë gjatë viteve 2021–2025. Nga 80 aktivitete në vitin 2021, numri është rritur gradualisht në 94 aktivitete në vitin 2022, 99 në vitin 2023 dhe 110 aktivitete në vitin 2024. Në vitin 2025 është regjistruar një rritje e ndjeshme, me 200 aktivitete të mbështetura nga bashkia. Kjo rritje tregon angazhimin e vazhdueshëm të Bashkisë Vlorë për zhvillimin e jetës kulturore dhe artistike të qytetit, përmes mbështetjes financiare të aktiviteteve që promovojnë kulturën, traditat, artin dhe turizmin. Organizimi dhe mbështetja e eventeve kulturore ndikon jo vetëm në pasurimin e jetës sociale të komunitetit, por edhe në promovimin e Vlorës si një qytet me aktivitet kulturor gjatë gjithë vitit, duke tërhequr vizitorë dhe duke krijuar më shumë hapësira për përfshirjen e artistëve, të rinjve dhe komunitetit në jetën publike.



BASHKIA VLORË



Trashëgimia kulturore, së bashku me eventet artistike dhe kulturore në Bashkinë Vlorë, përbëjnë një aset të rëndësishëm për identitetin lokal dhe zhvillimin e turizmit kulturor. Prioritet mbetet ruajtja, promovimi dhe vlerësimi i pasurive historike dhe kulturore, si dhe nxitja e aktiviteteve artistike gjatë gjithë vitit. Përmes organizimit të eventeve kulturore dhe bashkëpunimit me artistë e institucione, synohet rritja e pjesëmarrjes së komunitetit dhe forcimi i imazhit kulturor të qytetit.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe historike përmes eventeve dhe aktiviteteve.</li><li>• Bashkëpunimi me artistë, institucione kulturore në aktivitete artistike.</li><li>• Organizimi i aktiviteteve në kuadër të promovimit të qytetit si destinacion turistik dhe kulturor.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Mirëmbajtja dhe restaurimi i objekteve kulturore dhe historike.</li><li>• Pjesëmarrja e kufizuar në aktivitete kulturore gjatë periudhës jashtë sezonit.</li><li>• Nevoja për më shumë financime dhe hapësira kulturore moderne.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të qytetit.</li><li>• Mbështetja e artistëve të rinj dhe zhvillimi i aktiviteteve kulturore gjatë gjithë vitit.</li><li>• Zgjerimi i kalendarit kulturor, përmirësimi i infrastrukturës kulturore dhe promovimi ndërkombëtar i qytetit.</li></ul>





BASHKIA VLORË

Shpenzime për çdo banor	lekë/banorë	Totali i shpenzimeve për aport gjatë vitit të raportimit kundrejt numrit të popullsisë*	533.04	429.92	336.08
Objekte sportive funksionale	%	Raporti i numrit të objekteve funksionale kundrejt numrit total të objekteve sportive	100	100	100

\*sipas MF

### *Të dhënat e shërbimit*

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njësia matëse	2021	2022	2023	2024	2025
Struktura dhe terrene për veprimtari sportive (fusha lojërash, fusha tenisi, pishina noti, korsi vrapimi, ringje boksi, pista patinazhi, palestra etj)	numër	4	4	4	4	4
Hapësira publike çlodhëse dhe argëtuese në m2	m2	3500	3500	3500	3500	3500
Shpenzime për mbështetjen e veprimtarive sportive (në lekë)	lekë			71,966,000	58,044,000	45,374,000
Numri i stafit i angazhuar për shërbimin	numër	16	16	15	15	17
Numri i disiplinave sportive të mbështetura	numër	20	22	22	22	23

Sporti në Bashkinë Vlorë mbetet një prioritet në funksion të promovimit të jetesës aktive dhe përfshirjes së gjerë të komunitetit në aktivitete sportive. Fokus i veçantë i kushtohet përmirësimit të infrastrukturës sportive, mbështetjes së klubeve dhe zhvillimit të talenteve të reja. Përmes



BASHKIA VLORE

investimeve dhe bashkëpunimit me federatat dhe shoqatat sportive, synohet rritja e cilësisë së aktivitetit sportiv dhe promovimi i qytetit si qytet aktiv, sportiv dhe turistik.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Organizimi i aktiviteteve në kuadër të promovimit të qytetit si qytet aktiv, sportiv dhe turistik.</li><li>• Promovimi i qytetit përmes aktiviteteve sportive dhe angazhimi në iniciativa sportive qytetare.</li><li>• Mbështetje për klubet sportive dhe aktivitetet për fëmijë e të rinj.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Nevoja për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës sportive.</li><li>• Mungesa e hapësirave sportive në disa zona urbane dhe periferike.</li><li>• Kufizime financiare për zhvillimin e aktiviteteve dhe ekipeve sportive.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e numrit të aktiviteteve sportive gjatë gjithë vitit dhe promovimi i turizmit sportiv.</li><li>• Investime në fusha sportive, palestra dhe ambiente rekreative.</li><li>• Mbështetja e talenteve të reja dhe forcimi i bashkëpunimit me klubet sportive.</li></ul>



BASHKIA VLORE

## Kategoria: Mirëqeverisja

Qeverisja e mirë përfaqëson aftësinë institucionale të bashkisë për të ushtruar përgjegjësitë publike me integritet, transparencë dhe efikasitet, duke garantuar përfshirjen qytetare dhe barazinë e mundësive. Në kuadër të matjes së performancës vendore, qeverisja e mirë vlerësohet përmes katër fushave përfaqësuese, të cilat reflektojnë cilësinë e proceseve të brendshme dhe kapacitetin administrativ për të siguruar rezultate të qëndrueshme:

1. **Burimet Njerëzore** – masin strukturën, stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës vendore, si dhe nivelin e zhvillimit të kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore.
2. **Transparenca** – tregon nivelin e hapjes së informacionit dhe komunikimit me qytetarët, publikimin e akteve dhe respektimin e standardeve të qeverisjes së hapur.
3. **Barazia Gjinore** – reflekton përpjekjet institucionale për të siguruar përfaqësim të barabartë dhe përfshirje gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe politikëbërjes lokale.
4. **Integrimi në BE** – mat aftësinë e bashkisë për të përafuar praktikën e saj me standardet evropiane, përmes projekteve bashkëpunuese, partneriteteve ndërbashkiake dhe strukturave të dedikuara të integrimit..



BASHKIA VLORE

## BURIMET NJERËZORE, TRANSPARENCA, BARAZIA GJINORE DHE INTEGRIMI EUROPIAN

*Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshin jo vetëm plotësimin e vendeve të punë të qëndrueshme, por edhe përshtatjen e aftësive të punonjësve me nevojat në zhvillim të komuniteteve vendore. Administrata e apartatit të Bashkive i nënshtrohet rregullave të shërbimi civil shqiptar i cili rregullohet nga Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, i cili krijon një shërbim civil profesional, të bazuar në meritë dhe politikisht asnjans.*

*Transparenca dhe llogaridhënia janë elementë thelbësorë të qeverisjes së mirë në nivel vendor. Bashkitë kanë detyrimin të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, të publikojnë informacionin mbi veprimtarinë institucionale dhe të japin llogari për realizimin e detyrave të tyre. Këto parime përforcojnë besimin e publikut, përmirësojnë shërbimet dhe parandalojnë abuzimet me pushtetin.*

*Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element i rëndësishëm për ndërtimin e institucioneve demokratike, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme. Ajo nënkupton jo vetëm përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat publike dhe shërbimet vendore. Bashkitë duhet të garantojnë mundësi të barabarta në vendimmarrje, ofrim shërbimesh pa diskriminim dhe mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore. Gjithashtu, ato kanë detyrimin të zbatojnë buxhetimin gjinor dhe të raportojnë mbi masat konkrete të marra për promovimin e barazisë gjinore, në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare.*

*Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me *acquis communautaire* dhe përmbushjen e kritereve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve.*



BASHKIA VLORE

### *Treguesit e shërbimit*

Ky kapitull synon të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin. Treguesit janë përzgjedhur dhe zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, duke angazhuar institucione qendrore, bashkinë, organizata partnere dhe ekspertë të fushës, me qëllim sigurimin e një qasjeje të balancuar dhe të krahasueshme.

Treguesi	Njësia matëse	Përshkrimi	2023	2024	2025
<b>Burimet njerëzore</b>					
Punonjës për 1000 banorë	numër	Raporti i numrit total të punonjësve kundrejt popullsisë*, për 1000 banorë	6.6	9.9	10.9
Shkalla e rotacionit të punonjësve	%	Raporti i punonjësve të larguar gjatë vitit të raportimit kundrejt numrit total të punonjësve	77	55	51
Staf i trajnuar	%	Raporti i punonjësve të trajnuar gjatë vitit të raportimit kundrejt numrit total të punonjësve	13.8	6.4	4.7
<b>Transparenca</b>					
Realizimi i konsultimeve publike sipas parashikimeve ligjore	%	Raporti i numrit të konsultimeve publike të zhvilluara kundrejt numrit të akteve për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	100	100	100
Raporti Vendor i Transparencës në procesin e vendimmarrjes	Po=1, Jo=0	Publikimi në faqen zyrtare të Bashkisë i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	1	1	1
Plani Vendor i Integritetit	Po=1, Jo=0	Ekzistenca e Planit Vendor të Integritetit	0	1	1



BASHKIA VLORE

<b>Barazia Gjinore</b>					
Gra në pozicione drejtuese të larta	%	Raporti i numrit të grave në pozicione të larta (kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore) kundrejt numrit total të pozicioneve të larta	40.6	40.6	45.3
Gra në pozicione drejtuese të ndryshme	%	Raporti i numrit të grave në pozicione drejtuese të larta, të mesme, të ulta kundrejt numrit total të pozicioneve drejtuese	47.6	46.9	48
Plani Vendor i Barazisë Gjinore	Po=1, Jo=0	Ezistenca e Planit të miratuar Vendor për Barazinë Gjinore	0	0	0
<b>Integrimi European</b>					
Projekte të fituara kundrejt projekteve të aplikuar të BE-së	%	Raporti ndërmjet numrit të projekteve të fituara kundrejt aplikimeve për projekte në BE	2023-2024		2024-2025
			80		81
Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Performancës	Po=1, Jo=0	Ngritja dhe funksionimi i Njësive të Performancës në Bashki	0	1	1
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës	Po=1, Jo=0	Ekzistenca e Planit të miratuar Vendor për Migracionin dhe Diasporën	0	0	0
Komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë	Po=1, Jo=0	Ngritja e Komisionit të integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë	1	1	1

\*sipas MF

### ***Të dhënat e shërbimit***

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.



BASHKIA VLORE

<b>E dhëna</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>	<b>2025</b>
Punonjës të Bashkisë në total	numër	902	1350	1480
Numri total i punonjësve femra të Bashkisë	numër	700	745	764
Numri total i punonjësve në njësitë shpenzuese	numër	555	985	985
Numri total i punonjësve të administratës	numër	347	365	495
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e Bashkisë	numër	173	154	209
Numri total i punonjësve të bashkisë që janë larguar nga puna brenda vitit	numër	131	145	63
Numri total i punonjësve femra të bashkisë që kanë lëvizur nga puna brenda vitit	numër	71	85	31
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë që kanë lëvizur nga puna brenda vitit	numër	60	60	32
Numri i masave disiplinore të marra nga punonjësit e Bashkisë	numër	105	75	134
Numri total i punonjësve të trajnuar	numër	125	87	71
Numri total i punonjësve femra të trajnuara	numër	70	49	40
Numri total i punonjësve meshkuj të trajnuar	numër	55	38	31
Numri total i mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë	numër	16	15	15
Numri total i mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë të hapura për qytetarët	numër	16	15	15
Akte të miratuara nga Këshilli Bashkiak	numër	102	113	109
Numri total i vendimeve bashkiake	numër	102	113	109



BASHKIA VLORE

Numri i konsultimeve publike të parashikuara me ligj	numër	8	12	9
Numri i konsultimeve publike të kryera	numër	8	12	9
Vendime bashkiake të marra pas konsultimit me komunitetin	numër	8	12	9
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	numër	64	64	64
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv. Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	numër	26	26	29
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	numër	42	49	50
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	numër	20	23	24
Projekte të aplikuara me financim nga BE	numër	7	8	6
Projekte të fituara me financim nga BE	numër	5	7	6

Treguesit e burimeve njerëzore tregojnë një përmirësim gradual të kapaciteteve administrative të Bashkisë gjatë viteve 2023–2025. Rritja e numrit të punonjësve për 1000 banorë dhe ulja e rotacionit të stafit tregojnë stabilitet më të madh institucional dhe forcim të vazhdimësisë së shërbimeve publike. Megjithatë, rënia e përqindjes së stafit të trajnuar evidenton nevojën për fokusim në ngritjen profesionale të administratës. Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të dedikuara sipas kompetencave të çdo sektori mbetet thelbësor për rritjen e eficiencës, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përshtatjen me kërkesat e administrimit modern vendor dhe proceseve të integritit evropian.



BASHKIA VLORE

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ulje e rotacionit të stafit duke reflektuar më shumë stabilitet në administratë.</li><li>• Stabilizimi i stafit krijon kushte më të mira për ruajtjen e eksperiencës institucionale dhe rritjen e efikasitetit.</li><li>• Uje e numrit të punonjësve të larguar.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Nevoja për rritje të nivelit të trajnimeve për stafin.</li><li>• Rritja e cilësisë së burimeve njerëzore.</li><li>• Forcimi i transparencës institucionale.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Forcimi i stabilitetit institucional.</li><li>• Hartimi dhe zbatimi i një plani vjetor trajnimesh, i orientuar sipas nevojave konkrete të çdo sektori.</li><li>• Përmirësim i mekanizmave të transparencës.</li></ul>

Në aspektin e transparencës, Bashkia ka ruajtur një nivel të lartë të realizimit të konsultimeve publike dhe publikimit të raporteve të transparencës, duke dëshmuar angazhim të vazhdueshëm për informimin dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Këta tregues reflektojnë respektimin e standardeve ligjore dhe përmirësimin e komunikimit institucional me publikun. Miratimi dhe zbatimi i Planit Vendor të Integritetit përbën një instrument të rëndësishëm për forcimin e qeverisjes së mirë, rritjen e besimit të qytetarëve dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit apo korrupsionit.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Ruajtja e publikimit vjetor të raportit të transparencës.</li><li>• Zbatim i planit vendor të integritetit si instrument i rëndësishëm.</li><li>• Rritja e ndërgjegjësimit institucional mbi rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e ndërveprimit publik dhe pjesëmarrjes aktive në proceset konsultuese.</li><li>• Kanale komunikimi jo mjaftueshëm interaktive me qytetarët.</li><li>• Nevoja për digjitalizim më të avancuar të proceseve të transparencës dhe aksesit në informacion.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e pjesëmarrjes së publikut në konsultime publike.</li><li>• Publikimi i të dhënave në format të hapur dhe të kuptueshëm për qytetarët.</li><li>• Integrimi i teknologjisë për të rritur aksesin dhe besueshmërinë e informacionit publik.</li></ul>



BASHKIA VLORË

Treguesit e barazisë gjinore tregojnë një përfaqësim relativisht të mirë të grave në pozicionet drejtuese, me tendencë përmirësimi në vitin 2025, veçanërisht në nivelet e larta të drejtimit. Kjo situatë reflekton angazhimin për krijimin e një administrate më gjithëpërfshirëse dhe më të balancuar në aspektin gjinor. Hartimi i një Plani Vendor për Barazinë Gjinore do të ndihmonte në forcimin e politikave mbështetëse për gratë dhe vajzat, si dhe në garantimin e mundësive të barabarta në punësim, përfaqësim dhe zhvillim profesional.

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rritja e përqindjes së grave në pozicione drejtuese të larta.</li><li>• Rritja e përqindjes së grave në pozicione të ndryshme.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Forcimi i mekanizmave institucionalë për integrimin e perspektivës gjinore në politikatat vendore.</li><li>• Përmirësimi i mbledhjes së të dhënaave dhe analizës së të dhënave të disagreguara gjinore.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor të Barazisë Gjinore.</li><li>• Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozicione të ndryshme drejtuese dhe vendimmarrëse.</li></ul>

Treguesi i projekteve të fituara kundrejt projekteve të aplikuara në programet e Bashkimit European shënon një përmirësim të lehtë, duke kaluar nga 80% në periudhën 2023–2024 në 81% në periudhën 2024–2025. Ky rezultat tregon një kapacitet të qëndrueshëm dhe në rritje të institucionit për të përgatitur aplikime konkurruese dhe për të siguruar financime nga fondet e BE-së. Ruajtja e një niveli të lartë suksesi në aplikime dëshmon për përvojën e krijuar në menaxhimin e ciklit të projekteve dhe bashkëpunimin efektiv me partnerët përkatës. Një tjetër zhvillim pozitiv paraqet ngritja dhe funksionimi i Njesisë së Performancës nga viti 2024 e në vijim, si dhe funksionimi i Komisionit të Integritimit European pranë Këshillit Bashkiak. Nga ana tjetër, mungesa e një Plani të Migracionit dhe Diasporës tregon nevojën për hartimin e politikave më të strukturuar për adresimin e çështjeve që lidhen me diasporën dhe migracionin në nivel vendor.



BASHKIA VLORE

Arritje	Sfida	Objektiva
<ul style="list-style-type: none"><li>• Krijimi dhe funksionimi i sektorit të Performancës.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Mungesa e marrëveshjeve ndërbashkiake.</li><li>• Mungesa e Planit Vendor të Migracionit dhe Diasporës.</li><li>• Nevoja për rritjen e kapaciteteve të njësisë së integritit europian.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor të Migracionit dhe Diasporës.</li><li>• Rritja e numrit të projekteve të financuara nga BE të aplikuar dhe fituara.</li><li>• Rritja e numrit të marrëveshjeve ndërbashkiake.</li></ul>



BASHKIA VLORË

## Kategoria: Menaxhimi Financiar

Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Kjo kategori ndahet në tri fusha të veçanta, që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet dhe buxhetimi. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori janë renditur më poshtë.





BASHKIA VLORE

## Të Ardhurat

Kjo fushë vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe diversifikuara përmes burimeve të veta dhe atyre të transferuara. Analiza e të ardhurave kontribon në kuptimin e varësisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale. E drejta e njërive të vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura buron nga **neni 11 i Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”**, i cili përcakton butimet e të ardhurave që administrohen nga bashkitë.

Emri	Njësia matëse	2023	2024	2025
Të ardhurat e veta	mijë lekë	1,293,910	1,309,395	3,404,359

- *Të dhënat financiare*

Emri	Njësia matëse	2023	2024	2025
Të ardhurat sipas burimit taksa të tjera vendore	mijë lekë	146,104	282,536	310,698
Të ardhurat sipas burimit taksa e ndikimit në infrastrukturë	mijë lekë	276,466	203,028	613,000
Të ardhurat sipas burimit taksa e ndërtesës	mijë lekë	145,655	195,208	226,471
Të ardhurat sipas burimit tarifa per zënien e hapësirave publike	mijë lekë	105,454	92,791	132,865
Të ardhurat sipas burimit tarifa e pastrimit	mijë lekë	171,655	318,660	343,075
Të ardhurat sipas burimit taksa e tokës bujqësore	mijë lekë	11,719	14,764	19,780

- *Të ardhurat sipas burimit*

Analiza e të ardhurave sipas burimit për periudhën 2023–2025 tregon një tendencë përgjithësisht pozitive në performancën financiare të Bashkisë, me rritje të shumicës së kategorive të të ardhurave vendore. Të dhënat reflektojnë forcim gradual të kapaciteteve administrative dhe përmirësim të nivelit të arkëtimit.




BASHKIA VLORË

Gjatë periudhës së analizuar evidentohet rritje e të ardhurave nga taksat vendore dhe tarifrat, çka lidhet me zgjerimin e aktivitetit ekonomik, rritjen e ndërtimeve dhe përmirësimin e administrimit fiskal. Veçanërisht, të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë tregojnë varësi të lartë nga dinamika e sektorit të ndërtimit, duke paraqitur luhatje të ndjeshme nga një vit në tjetrin.

Nga ana tjetër, tarifrat e shërbimeve, kryesisht tarifa e pastrimit, paraqesin një rritje më të qëndrueshme, duke reflektuar përmirësim të mbulimit të shërbimit dhe të eficiencës në mbledhjen e të ardhurave.

Në tërësi, të dhënat tregojnë një tendencë pozitive të të ardhurave vendore dhe një stabilizim gradual të burimeve financiare të Bashkisë, megjithëse disa kategori mbeten të ndikuara nga zhvillimet ekonomike dhe aktiviteti i tregut.





BASHKIA VLORE

## Shpenzime

Kjo fushë analizon strukturën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike të bashkive për të përmbushur funksionet e tyre ligjore. Ajo vlerëson nëse fondet shpenzohen në mënyrë të efektshme dhe transparente. Bashkitë janë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve publike vendore, në përputhje me **nenin 12 dhe 13 të Ligjit nr. 68/2017** dhe aktet nënligjore përkatëse.

- *Të dhënat financiare*

Emri	Njësia matëse	2023	2024	2025
Shpenzime personeli	mijë lekë	1,045,761	1,278,100	1,463,494
Shpenzime operative	mijë lekë	659,313	727,500	770,537
Shpenzime kapitale/investime	mijë lekë	190,533	340,100	311,810
Shpenzime ekonomike të tjera	mijë lekë	29,157	39,700	29,669

- *Shpenzime sipas natyrës ekonomike*

Analiza e shpenzimeve për periudhën 2023–2025 tregon një rritje graduale të shpenzimeve të Bashkisë, e lidhur kryesisht me zgjerimin e aktivitetit administrativ dhe investimeve publike.

Shpenzimet e personelit paraqesin peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve dhe kanë ndjekur trend rritës gjatë gjithë periudhës. Kjo lidhet me rritjen e kostove të administratës dhe mbështetjen e funksioneve të shërbimeve publike. Edhe shpenzimet operative kanë shënuar rritje të qëndrueshme, duke reflektuar shtimin e kostove për funksionimin e përditshëm të shërbimeve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike.

Ndërkohë, shpenzimet kapitale/investime paraqesin luhatje nga një vit në tjetrin, çka tregon se niveli i investimeve është ndikuar nga realizimi i projekteve dhe prioritetet buxhetore të Bashkisë. Rritja e tyre në vitin 2024 dhe niveli relativisht i lartë edhe në vitin 2025 tregojnë fokus të vazhdueshëm në investimet publike. Shpenzimet ekonomike të tjera mbeten në nivele më të ulëta dhe relativisht të qëndrueshme gjatë periudhës së analizuar.



BASHKIA VLORE

Në tërësi, të dhënat tregojnë një strukturë financiare të orientuar kryesisht drejt mbulimit të kostove administrative dhe operacionale, duke ruajtur njëkohësisht angazhimin për investime publike dhe zhvillim të infrastrukturës.

